

JUSUF KASTRATI

PËR TY QË **S'**FALESH



+ SHTOJCA
**FORMA E
NAMAZIT**

Titulli

Për ty që (s')faleh

Autor

Jusuf Kastrati

Redaktor gjubësor

Jeton Koçinaj

Redaktor fetar

Burim Koçinaj

Dizajni

Fatlum Zeka

Boton

Instituti Germa

Mars, 2025

ISBN 978-9951-9125-8-7

Shitja e këtij libri ndalohet rreptësisht!

Copyright © Autori

E-mail: jusufo@gmail.com

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Namazi është lidhja e robit me Krijuesin	7
Fale namazin, që ta fitosh Xhenetin	9
Bëhu prej atyre që e falin sabahun.....	11
Përgatitu për Ditën kur do të japësh llogari	13
Si mendon të të shlyhen mëkatet pa u falur?	15
Asnjëherë mos e lër namazin e xhumasë	17
Mos lejo që pasuria dhe familja të të largojnë nga namazi	19
Kurrsesi mos e humb namazin e ikindisë	21
Fale namazin e sabahut dhe atë të ikindisë, që ta shohësh Zotin në jetën e amshuar.....	23
Nëse e do ndihmën e Allahut, fale namazin dhe ji i duruar	25
Fale gjithnjë me xhemat namazin e sabahut dhe atë të jacisë	28
Fale namazin, që Allahu të t'i shlyejë gjynahet përmes tij	30
Çdo të premtë pastrohu, vishu bukur dhe fale xhumanë	32
Merr abdes, shko në xhami dhe falu duke qenë i përlur	34
Namazi është shkak për tejkalimin e vështirësive.....	36

Jepja besën Allahut se do ta falësh rregullisht namazin	38
Fali pesë namazet ditore, që të jesh i lumtur në këtë botë dhe në tjetrën	40
Mësoje familjen tënde që të falin namazin	42
Asnjëherë mos e harro qëllimin e krijimit	44
Fale namazin, që është nur, e mos rri në terr	47
Dy rekate janë më të vlefshme se kjo botë dhe ç'ka në të	49
Eja në namaz, eja në shpëtim!.....	51
Fal namaz nate dhe sillu mirë me njerëz	53
Lute Allahun që të të bëjë ty dhe familjen tënde namazlinj	55
Mos lejo që imani yt të vihet në pikëpyetje	57
Pendohu para se të të vijë vdekja	59
Fale namazin në kohë të caktuar.....	61
Merr abdes mirë dhe fale namazin në xhami.....	63
Fale namazin gjithmonë me përrulje	65
Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja	67
Mëso faljen e namazit	69

ME EMRIN E ALLAHUT,
TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT!

PARATHËNIE

Lavdërimet e plota i takojnë vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush që e humb, kurse atë që Allahu e lë në humbje, nuk ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se Allahu është i vetmi që meriton të adhurohet dhe se Muhamedi ^{صلى الله عليه وسلم} 1 është rob dhe i dërguar i Tij.

Libri që keni para duarsh bën fjalë për shtyllën e dytë të fesë islame, për namazin. Jam përpjekur që në këtë libërth të paraqes dobitë më të rëndësishme të këtij ibadeti madhështor, duke sjellë dëshmi të ndryshme nga Kurani, nga hadithet e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit ^{صلى الله عليه وسلم}, dhe nga thëniet e dijetarëve. Por, megjithatë, realitetin e namazit mund ta kuptojë vetëm ai që e zbaton atë në mënyrë të denjë. Kënaqësia të cilën besimtari e gjen në namaz dhe përgjithësisht në adhurim ndaj Allahut nuk mund të përshkruhet me fjalë. Për këtë arsye, njëri nga

¹ Sal-lallahu alejhi ue sel-lem (shqip: paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

dijetarët thoshte: "Po ta dinin mbretërit dhe bijtë e tyre se në çfarë kënaqësie ndodhemi ne, do të na luftonin me shpata për të na e marrë atë."

Librin e kam ndarë në tridhjetë mësimë. E veçanta e tij është se në çdo mësim kam përmendur nga një mëdyshje, që shejtani ua hedh njerëzve në mendje për t'i lënë sa më larg namazit, porse çdo mëdyshjeje i jam përgjigjur shkurtimisht, duke dëshmuar se në të vërtetë njeriu nuk ka arsye për të mos falur namazin.

Për fund, falënderoj përzemërsisht të gjithë ata që ndihmuan në realizimin dhe botimin e këtij libërthi.

Lus Allahun Fuqiplotë që kushdo që e lexon këtë libër të ketë dobi prej tij!

Autori

Mësimi i parë

NAMAZI ËSHTË LIDHJA E ROBIT ME KRIJUESIN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿قُلْ لِعِبَادِيَ الَّذِينَ آمَنُوا يُقِيمُوا الصَّلَاةَ﴾

"Thuaju robërve të Mi që besuan, që të falin namazin..."
(Kurani, 14:31)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:
"Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla): (1) të dëshmuarit se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij, (2) faljen e namazit, (3) dhënien e zekatit, (4) haxhillëkun dhe (5) agjërimin e Ramazanit."²

² Buhariu 8, Muslimi 16.

URTËSI

Ibn Kajimi thoshte: "Namazi sjell furnizimin (rizkun), ruan shëndetin, shmang dëmin, përzë sëmundjet, forcon zemrën, shndrit fytyrën, kënaq shpirtin, flak përtacinë, gjallëron gjymtyrët, dhuron fuqi, zgjeron kraharonin, ushqen shpirtin, zbardh zemrën, ruan begatinë, largon ndëshkimin, tërheq bereqetin, të mban larg nga shejtani dhe të afron me të Gjithëmëshirshmin."³

MËDYSHJE

Namazi është i rëndë për t'u kryer (!)

Po të ishte namazi i vështirë, nuk do ta kryenin miliona njerëz. Përkundrazi, namazi, jo vetëm që është i lehtë, por është edhe shkak për lehtësimin e të gjitha punëve. Në të vërtetë, namazi është *çelësi i suksesit*.

KËSHILLË

Namazi është lidhja e robit me Krijuesin, andaj, nëse vërtet e do Zotin tënd, përgjigju thirrjes së Tij; fillo ta falësh namazin e mos e lër për nesër!

³ Zatul-mead fi hedji hajril-ibad, f. 304.

Mësimi i dytë

FALE NAMAZIN, QË TA FITOSH XHENETIN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي﴾

"Me të vërtetë, Unë jam Allahu, askush përveç Meje nuk meriton të adhurohet. Pra, vetëm Mua më adhuro dhe fale namazin për të më kujtuar Mua!" (Kurani, 20:14)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Allahu ka marrë përsipër që, çdonjërin që e beson Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e fal namazin dhe agjëron Ramazanin, ta fusë në Xhenet, pa marrë parasysh nëse ka bërë hixhret në rrugën e Allahut apo ka qëndruar në vendlindje."⁴

⁴ Buhariu 7423.

URTËSI

Ibn Kajimi ka thënë: "Fshehtësia, shpirti dhe thelbi i namazit qëndron në kthimin e robit drejt Allahut me tërë qenien e tij. Ashtu siç nuk bën që robi teksa është në namaz ta largojë fytyrën nga kibla e ta kthejë në ndonjë anë tjetër, po ashtu nuk bën që ta kthejë zemrën nga dikush tjetër pos Allahut."⁵

MËDYSHJE

Kam turp të falem (!)

Ai që meriton më së shumti të kemi turp prej Tij pa dyshim që është Zoti ynë, i Cili na ka premtuar se, po që se e falim namazin, do të na fusë në Xhenet, ku ka gjëra që syri s'i ka parë, veshi s'i ka dëgjuar e as që mund t'i marrë me mend dikush. Rrjedhimisht, ne duhet të turpërohemi nga Krijuesi ynë dhe ta falim namazin. Së këndejmi, në mes tjerash, turpemadh është pikërisht ai që s'falet.

KËSHILLË

Falu, që ta fitosh Xhenetin dhe të shpëtosh nga Zjarri!

⁵ Esrarus-salah, f. 115.

BËHU PREJ ATYRE QË E FALIN SABAHUN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿أَقِمِ الصَّلَاةَ لِدُلُوكِ الشَّمْسِ إِلَى غَسَقِ اللَّيْلِ وَقُرْآنَ الْفَجْرِ إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ
كَانَ مَشْهُودًا﴾⁶

"Fale namazin prej animit të Diellit (pas zenitit) deri në errësirën e natës dhe lexo Kuran në namazin e sabahut, sepse Kurani që lexohet në namazin e sabahut është i dëshmuar (nga melekët)." (Kurani, 17:78)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi صلى الله عليه وسلم, ka thënë:

“Ai që e fal sabahun, e ka garancinë e Allahut.”⁶

⁶ Muslimi 261.

URTËSI

Hasen el Basriu thoshte: "O biri i Ademit! Në qoftë se e nënvlerëson namazin, cila çështje e fesë të qenka e rëndësishme?!"⁷

MËDYSHJE

Jam zemërmirë, ndaj nuk kam pse falem (!)

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, na ka treguar se, për çdo mëkat që bën njeriu, i vendoset nga një njollë e zezë në zemër... Atëherë, si mund të jetë zemërbardhë ai që së paku pesë herë në ditë e zezon zemrën e tij duke mos u falur, përkatësisht mëkaton ndaj Allahut?!

KËSHILLË

Bëhu prej atyre që e falin sabahun, në mënyrë që ta fitosh garancinë e Allahut, dhe kurrë mos e nënvlerëso namazin, sepse ai është shtylla e fesë.

⁷ Shuabul-iman, Bejhakiu (4/514).

PËRGATITU PËR DITËN KUR DO TË JAPËSH LLOGARI

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿قُلْ إِنَّ هُدَى اللَّهِ هُوَ الْهُدَىٰ وَأُمِرْنَا لِنُسَلِّمَ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٧١﴾ وَأَنْ أَقِيمُوا
الصَّلَاةَ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَهُوَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٧٢﴾﴾

“Thuaj: "Pa dyshim, udhëzimi i Allahut është udhëzimi i vërtetë dhe ne jemi urdhëruar t'i nënshtrohem Zotit të botëve, të falim namazin dhe të kemi frikë nga Ai." Është Ai para të Cilit do të tuboheni.” (Kurani, 6:71-72)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Gjëja e parë për të cilën robi do të merret në llogari Ditën e Gjykimit është namazi. Nëse atë e ka në rregull, do të fitojë e do të shpëtojë. Mirëpo, nëse atë nuk e ka në rregull, do të humbë e do të dëshpërohet."⁸

⁸ Nesaiu 464.

URTËSI

Ibn Kajimi ka thënë: "Robi ka dy qëndrime përpara Allahut: një qëndrim në namaz, ndërsa qëndrimin tjetër në ditën kur ta takojë Atë. Kush e përmbush me përkushtim të parin, do ta ketë të lehtë të dytin, e, kush e neglizhon dhe nuk i jep hakun këtij qëndrimi, do ta ketë të rëndë qëndrimin e fundit."⁹

MËDYSHJE

Ka kohë, falem kur të plakem (!)

Askush nuk e di si e kur do t'i vijë vdekja. Ajo nuk pyet moshë e as gjini. Vdekja vjen krejt papritmas, sidomos në kohën që po jetojmë tani, që, për shkak të sëmundjeve të shumta vdekjeprurëse e aksidenteve fatale, vdekja e të rinjve dhe të rejave është bërë më se normale. Andaj, rri i përgatitur në çdo moment, sepse vdekja ndjek shpirtin sikurse hija trupin.

KËSHILLË

Bëhu gati për Ditën kur do të japësh llogari. Në asnjë mënyrë mos e tako Allahun pa namaz, ngase do të jesh i dëshpëruar përherë!

⁹ El-Fevaid, f. 200.

SI MENDON TË TË SHLYHEN MËKATET PA U FALUR?

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ﴾

"... dhe fale namazin! Vërtet, namazi pengon nga veprat e shëmtuara e të këqija..." (Kurani, 29:45)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, shokëve të vet u kishte thënë: *"Çka mendoni, sikur para derës së ndonjërit prej jush të ishte një lumë, ku ai do të lahej pesë herë në ditë, a do t'i mbetej ndonjë ndyrësi në trup?"* Ata thanë: *"Nuk do të mbetej as edhe një ndyrësi e vetme."* Atëherë i Dërguari ﷺ u tha: *"Kjo u shëmbëllen pesë kohëve të namazit, me të cilat Allahu i pastron mëkatet."*¹⁰

¹⁰ Buhariu 528, Muslimi 667.

URTËSI

Ibn Xhuzeji ka thënë: "Nëse njeriu është i përvulur në namaz dhe kujton madhësitë e Atij para të Cilit është duke qëndruar, kjo bën që ai të pendohet nga punët e ndyra e të shëmtuara. Rrjedhimisht, namazi e ndalon atë nga veprat e këqija."¹¹

MËDYSHJE

E si të falem, kur jam gjynahqar (!)

Nëse pendohesh dhe e fal namazin, Allahu do të t'i shlyejë të gjitha mëkatet, por, nëse vazhdon të mos falesh, gjynahet e tua do të të mbulojnë të tërin.

KËSHILLË

Vallë, ende mendon se një ditë do të të shlyhen mëkatet, ndërkohë vazhdon të mos falesh?!

¹¹ Tefsir Ibn Xhuzej (2/126).

Mësimi i gjashtë

ASNJËHERË MOS E LËR NAMAZIN E XHUMASË

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَالَّذِينَ يُمَسِّكُونَ بِالْكِتَابِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ إِنَّا لَا نَضِيعُ أَجْرَ الْمُصْلِحِينَ﴾⁽¹²⁾

"Sa u përket atyre që i përmbahen Librit dhe e falin namazin, (le ta dinë se) Ne nuk do t'ua humbim shpërblimin punëmirëve." (Kurani, 7:170)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Pesë namazet ditore, prej njërit deri te tjetri, namazi i xhumasë, prej njërit deri te tjetri, dhe Ramazani, prej njërit deri në Ramazanin tjetër, shlyejnë gjynahet që janë në mes tyre, nëse ruheni prej mëkateve të mëdha.”¹²

¹² Muslimi 233.

URTËSI

Ibn Kajimi thoshte: "Besimtarëve u dhurohet nderi më i madh në ditën e xhuma: atë ditë ata përcillen drejt banesave e pallateve të tyre në Xhenet; është dita kur u shtohen mirësitë pasi të kenë hyrë në Xhenet; dita e festës në këtë botë dhe dita kur Allahu i Plotfuqishëm ua plotëson lutjet dhe nevojat, pa refuzuar askënd që i drejtohet Atij."¹³

MËDYSHJE

Nuk mund të falem, sepse s'mund të beq dorë nga gjynabet (!)

Për asnjë arsye mos e lër namazin! Falu, edhe në qofsh mëkatari më i madh! Nëse e fal namazin, Allahu do të të ndihmojë të bëhesh besimtar i denjë dhe të largohesh nga punët e këqija.

KËSHILLË

Asnjëherë mos e lër namazin javor, atë të xhumasë, por fale, që ta fitosh mëshirën dhe kënaqësinë e Zotit tënd Bujar!

¹³ Zadul-meat fi hedji hajril-ibad (1/364).

MOS LEJO QË PASURIA DHE FAMILJA TË TË LARGOJNË NGA NAMAZI

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُلْهِكُمْ أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَاؤُكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ﴾¹⁴

"O besimtarë! Mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t'ju largojnë nga përmendja e Allahut.¹⁴ Ata që veprojnë kështu, mu ata janë të humburit." (Kurani, 63:9)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Kur njeriu bie në gjumë, shejtani ia lidh në kokë tri nyja dhe i thotë: ‘Fli, ngase ke natë të gjatë përpara!’ Nëse ngrihet dhe e përmend Allahun, i zgjidhet njëra nyjë; nëse merr abdes, i zgjidhet tjetra; nëse ngrihet dhe e fal

¹⁴ Ata ibn Rabahu ka thënë: “Me të përmendurit e Allahut është për qëllim namazi i detyrueshëm.” [Tefsir El-Maverdi (6/18)]

namazin, i zgjidhen të gjitha nyjat dhe bëhet aktiv e shpirtdëlirë. Në të kundërtën, bëhet shpirtlig dhe përtac.”¹⁵

URTËSI

Ebul-Hasen el-Haraliu ka thënë: "Atij që i ruan namazet, Allahu ia përmirëson gjendjen në këtë botë dhe në botën e amshuar."¹⁶

MËDYSHJE

Jam i zënë, nuk kam kohë për namaz (!)

Namazi i detyrueshëm nuk të merr kohë më shumë se pesë minuta. Për t'i falur pesë kohët të nevojiten vetëm 30 minuta brenda 24 orësh. Pyete veten se sa orë i harxhon në gjëra të kota...! Vallë, nuk mundke të ndash një gjysmë ore për Krijuesin tënd?!

KËSHILLË

Mos lejo që familja a pasuria që ta ka dhënë Allahu të bëhen shkak që të largohesh nga namazi! Kundrejt asnjë çmimi mos e lejo veten të bëhesh i përhumur.

¹⁵ Buhariu 1142, Muslimi 776.

¹⁶ Nadhmud-durar fi tenasubil-ajati ues-suver, el-Bekai (3/362).

Mësimi i tetë

KURRSESI MOS E HUMB NAMAZIN E IKINDISË

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿حَافِظُوا عَلَى الصَّلَوَاتِ وَالصَّلَاةِ الْوُسْطَىٰ وَقُومُوا لِلَّهِ قَانِتِينَ﴾

"Kushtojuni kujdes namazeve, veçanërisht namazit të mesëm dhe faluni duke qenë të përlur ndaj Allahut."
(Kurani, 2:238)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Nëse ndokujt i ikën namazi i ikindisë pa e falur, kjo është për të sikurse t'i kishin humbur familja dhe pasuria e tij."¹⁷

¹⁷ Buhariu 3602, Muslimi 2886.

URTËSI

Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) u shkruante letër nëpunësve dhe guvernatorëve të tij, duke u thënë: "Për mua, gjëja më e rëndësishme që bëni është namazi. Ai që e ruan atë, e ka ruajtur fenë e vet, kurse ai që e humb atë, punët e tjera i humb edhe më lehtë."¹⁸

MËDYSHJE

Dua të falem, por kam frikë mos po e lë dikur namazin (!)

Në qoftë se ende nuk falesh, ti tashmë ashtu se ashtu e ke lënë namazin, por, kur fillon të falesh dhe ta shijosh kënaqësinë e namazit, më nuk do të mund të ndahesh prej tij.

KËSHILLË

Kurrsesi mos e humb namazin e mesëm, atë të ikindisë; ta ruash si sytë e ballit!

¹⁸ Muvetta, el-Imam Malik (1/6).

FALE NAMAZIN E SABAHUT DHE ATË TË IKINDISË, QË TA SHOHËSH ZOTIN NË JETËN E AMSHUAR

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿فَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ
الْغُرُوبِ﴾

"Pra, duro atë që thonë ata dhe lartësoje Zotin tënd me lavdërim para lindjes së Diellit dhe para perëndimit!"
(Kurani, 50:39)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi صلى الله عليه وسلم, ka thënë:

"Do ta shihni Zotin tuaj siç po e shihni Hënën: s'do të shtyheni për ta shikuar Atë. Andaj, ai që mund ta ruajë namazin para lindjes së diellit dhe atë para perëndimit, le ta bëjë!" Pastaj lexoi: "... *madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit.*" (Kaf, 39)¹⁹

¹⁹ Buhariu 554, Muslimi 633.

URTËSI

Ibn Kajimi thoshte: "Zemrat nuk gjejnë qetësi e shpirtrat nuk përjetojnë rehati përveçse pranë Allahut, duke shijuar ëmbëlsinë e përmendjes, përluljes dhe afrimit me Të, veçanërisht në sexhde, kur robi është më afër Zotit të vet."²⁰

MËDYSHJE

Nëse falem, do të më quajnë ekstremist (!)

Ekstremist i vërtetë është ai që tregohet kokëlartë kundrejt Zotit të vet, duke mos përfillur urdhrat e Tij dhe duke penguar njerëzit nga feja e drejtë. Kështu që, nëse ndokush të quan ekstremist, duro për hir të Zotit tënd dhe mos ua vër veshin fjalëve të njerëzve, sepse ata do të pendohen për mosbindje ndaj Zotit të tyre.

KËSHILLË

Fale namazin e sababut dhe atë të ikindisë, që ta shobësh Zotin tënd! Të parët në fytyrën e Krijuesit është kënaqësia më e madhe që ekziston, andaj mos e humb atë!

²⁰ Risaletu Ibn el-Kajjim ila ehad ihuanihi, f. 33.

NËSE E DO NDIHMËN E ALLAHUT, FALE NAMAZIN DHE JI I DURUAR

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَاسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ وَإِنَّهَا لَكَبِيرَةٌ إِلَّا عَلَى الْخَاشِعِينَ ﴿٤٥﴾ الَّذِينَ يَظُنُّونَ
أَنَّهُمْ مُلَاقُوا رَبِّهِمْ وَأَنَّهُمْ إِلَيْهِ رَاجِعُونَ ﴿٤٦﴾﴾

"Kërkoni ndihmë me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të përlurit, të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai." (Kurani, 2:45-46)

THËNIE PROFETIKE

Muadh ibn Xhebeli (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka treguar se ka thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Më trego një punë që më çon në Xhenet dhe që më largon nga Zjarri!” Ai tha: "Vërtet ke kërkuar një çështje të madhe, që është e lehtë vetëm për atë të cilit Allahu ia lehtëson: ta adhurosh Allahun pa i shoqëruar asgjë në adhurim, ta falësh namazin, ta japësh

zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta kryesh haxhillëkun."²¹

URTËSI

Ibn Kajimi ka thënë: "Namazi ka një fuqi të jashtëzakonshme për të larguar të këqijat e kësaj bote, veçanërisht kur kryhet me përkushtim të plotë, si në aspektin e jashtëm, ashtu dhe në atë shpirtëror. Asnjë adhurim tjetër nuk i largon sprovat dhe të ligat e kësaj bote dhe të botës tjetër e as sjell mirësi dhe begati si namazi. Sekret i gjithë kësaj është se namazi është lidhja e drejtpërdrejtë e robit me Zotin e vet. Rrjedhimisht, sa më e fortë të jetë kjo lidhje, aq më shumë hapen për njeriun dyert e mirësive, largohen prej tij shkaqet e së keqes dhe i dhurohen nga Zoti i tij mbarësi, shëndet, begati, mirëqenie, qetësi shpirtërore dhe gëzim – të gjitha i afrohen me nxitim."²²

²¹ Tirmidhiu 2616, Nesaiu 11394, Ibn Maxhe 3973, Ahmedi 22016.

²² Et-Tib en-Nebevi, f. 251.

MËDYSHJE

Nuk mund të falem, se jam i sëmurë (!)

Allahu nuk e ka liruar nga moskryerja e namazit as të sëmurin, as udhëtarin, madje as atë që lufton në rrugën e Tij. Në rast se ndokush nuk mund të falet në këmbë, atëherë duhet të falet ulur, e, nëse nuk mundet as ulur, atëherë falet shtrirë, por në asnjë rrethanë nuk lirohet nga namazi. Vetëm i çmenduri nuk e ka për detyrë të falet.

KËSHILLË

Nëse e dëshiron ndihmën e Allahut, fale namazin dhe ji i durueshëm! Kështu arrihet fitoria e vërtetë!

Mësimi i njëmbëdhjetë

FALE GJITHNJË ME XHEMAT NAMAZIN E SABAHUT DHE ATË TË JACISË

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ
وَهُمْ رَاكِعُونَ﴾

"Në të vërtetë, miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët, të cilët e falin namazin, e japin zekatin dhe janë të përlurur (ndaj Allahut)." (Kurani, 5:55)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Ai që e fal jacinë me xhemat, konsiderohet sikurse ta ketë kaluar gjysmën e natës në namaz; ndërkaq, ai që e fal (edhe) sabahun me xhemat, konsiderohet sikurse ta ketë kaluar tërë natën në namaz.”²³

²³ Muslimi 1491.

URTËSI

Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: "Për atë që mungonte në faljen e namazit të jacisë dhe sabahut me xhemat, kishim frikë se ka rënë në hipokrizi."²⁴

MËDYSHJE

Nëse falem, do të më humbë respekti në shoqëri (!)

Përkundrazi, Allahu e ngrit falësin e namazit dhe e bën të respektueshëm në mesin e njerëzve. Madje, krahas kësaj, ai fiton edhe shokë të tjerë, të cilët e duan thjesht për Allahun, pa kurrfarë interesi të kësaj bote.

KËSHILLË

Namazin e sabahut dhe atë të jacisë fale gjithnjë me xhemat e në xhami, që të fitosh shpërblime madhështore nga Zoti yt dhe të jesh i ruajtur nga hipokrizia!

²⁴ Sahih Ibn Huzejme (1485), El-Mustedrak alas-Sahihajn, El-Hakim (764).

Mësimi i dymbëdhjetë

FALE NAMAZIN, QË ALLAHU TË T'I SHLYEJË GJYNAHET PËRMES TIJ

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأَقِمِ الصَّلَاةَ طَرَفِي النَّهَارِ وَزُلْفًا مِنَ اللَّيْلِ إِنَّ الْحَسَنَاتِ يُذْهِبُنَ السَّيِّئَاتِ
ذَلِكَ ذِكْرَى لِلذَّاكِرِينَ﴾

“Fale namazin në dy skajet e ditës dhe në një pjesë të natës, se, pa dyshim, punët e mira i shlyejnë punët e këqija. Kjo është këshillë për ata që marrin mësim.” (Kurani, 11:114)

THËNIE PROFETIKE

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Një njeri kishte puthur një grua (të huaj) dhe më pas kishte vajtur (i penduar) te Pejgamberi صلى الله عليه وسلم dhe e kishte njoftuar për mëkatin që kishte bërë. Atëherë, Allahu i Madhëruar zbriti ajetin: “Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija.” (Kurani, 11:114) Burri pyeti: "O i Dërguari i

Allahut! A vlen kjo vetëm për mua?" Ai i tha: "Vlen për gjithë umetin tim."²⁵

URTËSI

Ibn Kajimi thoshte: "Teksa robi gjendet në namaz, kibël të fytyrës dhe trupit le ta ketë Qabenë, kurse kibël të zemrës dhe shpirtit le ta ketë Zotin e Qabesë."²⁶

MËDYSHJE

Namazi është i vështirë për t'u mësuar (!)

Namazi mësohet shumë lehtë, sepse është diçka që përsëritet vazhdimisht. Posa të fillosh ta mësosh, do të bindesh në këtë që po lexon.

KËSHILLË

Askush nga ne nuk shpëton nga mëkatimi, andaj falu, që Allahu të t'i shlyejë gjynahet përmes namazit, sepse veprat e mira i shlyejnë të këqijat!

²⁵ Buhariu 526, Muslimi 2763.

²⁶ Esrarus-salah, f. 115.

ÇDO TË PREMTE PASTROHU, VISHU BUKUR DHE FALË XHUMANË

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ
وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾²⁷

"O besimtarë! Kur të thirreni për namaz ditën e xhuma, shpejtoni drejt përmendjes së Allahut dhe lini tregtinë. Kjo është më mirë për ju, nëse e dini." (Kurani, 62:9)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Atij që lahet (tërësisht - merr gusël), pastaj shkon për ta falur namazin e xhumasë dhe falet aq sa i është caktuar të falet, dëgjon me vëmendje hytben derisa të mbarojë, mandej falet pas imamit, do t'i falen mëkatet e bëra mes dy xhumave dhe të tri ditëve pas tyre."²⁷

²⁷ Buhariu 883.

URTËSI

Ali 'Tantavi thoshte: "Në këtë botë nuk ka asgjë më madhështore e më të bukur se namazi."²⁸

MËDYSHJE

Do të falem pasi ta mësoj namazin (!)

Fillo të falesh që tani, e mos bjer në kurthet e shejtanit!
Falu, qoftë edhe duke shikuar në ndonjë libër ose letër në të cilën sqarohet mënyra e faljes, derisa të mësohesh.

KËSHILLË

Çdo të premte pastrohu tërësisht, vish rroba të bukura, shko në xhami për të falur namazin e xhumasë dhe dëgjoje hytben me kujdes, që të fitosh faljen e të Gjithëmëshirshmit!

²⁸ Min hadithi en-nefs, f. 26.

MERR ABDES, SHKO NË XHAMI DHE FALU DUKE QENË I PËRULUR

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا وَاعْبُدُوا رَبَّكُمْ وَافْعَلُوا الْخَيْرَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾⁽⁷⁷⁾

"O ju që besoni, bjerni në ruku e sexhde dhe adhuroni Zotin tuaj e bëni vepra të mira, që të shpëtoni!" (Kurani, 22:77)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Sa herë që një musliman e zë ndonjë namaz i detyrueshëm dhe merr abdes si duhet, përulet në namaz dhe bën rukutë në mënyrë të denjë, atij i falen mëkatet e mëparshme, nëse ruhet nga mëkatet e mëdha. Kjo vlen përgjithmonë."²⁹

²⁹ Muslimi 228.

URTËSI

Ibn Tejmija ka thënë: "Namazi është ushqim për zemrën, ashtu siç është ushqimi për trupin. Nëse trupi nuk mund të mbijetojë me pak ushqim, as zemra nuk mund të ushqehet duke micëruar në namaz. Zemra ka nevojë për një namaz të plotë (dhe të përqendruar) që ta ushqejë e ta mbajë gjallë."³⁰

MËDYSHJE

Përtoj të marr abdes, prandaj s'falem (!)

Abdesi freskon trupin dhe shpirtin, sjell shpërblime të mëdha dhe shlyen mëkatet. Ai që përsiat mirësitë e tij, asnjëherë nuk përton të marrë abdes.

KËSHILLË

Merr abdes si dubet, shko në xhami dhe fale namazin duke qenë i përulur!

³⁰ El-Kavaid en-nuraniye, f. 60.

Mësimi i pesëmbëdhjetë

NAMAZI ËSHTË SHKAK PËR TEJKALIMIN E VËSHTIRËSIVE

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ﴾

"O besimtarë! Kërkoni ndihmë përmes durimit e namazit, sepse, pa dyshim, Allahu është me durimtarët!" (Kurani, 2:153)

THËNIE PROFETIKE

Hudhejfe ibn Husejni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: "Kur të Dërguarit të Allahut صلی الله علیه وسلم i vështirësohej ndonjë çështje, falte namaz."³¹

³¹ Ebu Davudi 1319.

URTËSI

Abdurrahman es Sadi ka thënë: "Nëse namazi i robit është i plotë, gjejësisht i përfshin gjërat e detyrueshme, të pëlqyeshmet dhe praninë e zemrës..., atëherë nuk ka dyshim se namazi i tillë është një prej shkaqeve që më së shumti e ndihmon njeriun në të gjitha çështjet."³²

MËDYSHJE

Namazi më vë pengesa në jetë (!)

Namazi është prej shkaqeve kryesore për lehtësimin dhe tejkalimin e të gjitha vështirësive. Pra, namazi sjell gjithnjë lehtësimin dhe asnjëherë vështirësinë. Kushdo që e ka provuar, është bindur në këtë.

KËSHILLË

Kërko ndihmë nëpërmjet durimit dhe namazit, që Allahu të të shpëtojë nga vështirësitë dhe të t'i largojë brengat!

³² Tejsir el-Kerim er-Rrahman, f. 74.

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë

JEPJA BESËN ALLAHUT SE DO TA FALËSH RREGULLISHT NAMAZIN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۖ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ۝ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ۖ وَالْآخِرَةُ خَيْرٌ وَأَبْقَى ۝﴾

"Njëmend i shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet e që fal namazin. Por ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote, ndërsa jeta tjetër është më e mirë dhe më e qëndrueshme." (Kurani, 87:14-17)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Allahu i Madhërishëm ka thënë: "Unë ia kam bërë detyrë umetit tënd pesë namaze dhe kam dhënë besën se, kushdo që i ruan ato, duke i falur në kohën e tyre, do ta fus në

Xhenet, kurse për atë që nuk i ruan ato, nuk kam dhënë besë."³³

URTËSI

Ibn Ashuri thoshte: "Allahu (në ajetin e mësipërm) ka përmendur pastrimin para përmendjes së Zotit dhe namazit, për shkak se ai është thelbi i këtyre veprave. Kjo, se, kur pastrohet shpirti, në të ndriçon nuri i udhëzimit, rrjedhimisht e kupton vlerën dhe dobinë e këtyre veprave (dhikrit dhe namazit), andaj i shton ato."³⁴

MËDYSHJE

Nesër do të filloj të falem (!)

E kush të siguron ty se do ta arrish ditën e nesërme? Mos harro asnjëherë, vdekja vjen papritmas! Të shumtën e herëve lënia e një mirësie për nesër është kurth i shejtanit që të mos fillosh sot mbarësinë.

KËSHILLË

Allahu ka dhënë besën se do ta fusë në Xhenet atë që i fal pesë namazet e detyrueshme ditore, andaj jepja edhe ti besën Allahut se do të kujdesesh për namazin, në mënyrë që Allahu të të bëjë banor të Xhenetit, sepse Ai nuk e thyen premtimin!

³³ Ebu Davudi 430, Ibn Maxhe 1403.

³⁴ Et-Tahrir uet-tenuir (30/288).

Mësimi i shtatëmbëdhjetë

FALI PESË NAMAZET DITORE, QË TË JESH
I LUMTUR NË KËTË BOTË DHE NË
TJETRËN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿لَيْنَ أَقَمْتُمُ الصَّلَاةَ وَآتَيْتُمُ الزَّكَاةَ وَآمَنْتُمْ بِرُسُلِي وَعَزَّرْتُمُوهُمْ وَأَقْرَضْتُمُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَلَأُدْخِلَنَّكُمْ جَنَّاتٍ تَجْرَى مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ﴾

"Në qoftë se e falni namazin, e jepni zekatin, i besoni të dërguarit e Mi, i përkrahni ata dhe i jepni Allahut hua të mirë, gjithsesi do t'ju shlyej gjynahet tuaja dhe do t'ju fus në kopshte të Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenj."
(Kurani, 5:12)

THËNIE PROFETIKE

Një njeri e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ duke i thënë: "Në qoftë se unë i fal namazet e detyrueshme, e agjëroj Ramazanin, hallallin e quaj hallall e haramin haram

dhe nuk shtoj asgjë tjetër, a do të hyj në Xhenet? I Dërguari i tha: "Po."³⁵

URTËSI

Ibn Kajimi thoshte: "Aq sa kthehet robi nga Allahu në namazin e tij, po aq kthehet Allahu nga ai. E, nëse robi ia kthen shpinën Allahut, edhe Ai do t'ia kthejë shpinën atij."³⁶

MËDYSHJE

Namazi më privon nga kënaqësitë e kësaj bote (!)

Kur është fjala për gjërat e lejuara, që janë kënaqësi të vërteta e jo të rreme, namazi nuk e pengon njeriun nga asnjëra prej tyre. Madje, në të vërtetë, askush nuk mund ta arrijë kënaqësinë e vërtetë pa e falur namazin.

KËSHILLË

Nëse po e kërkon lumturinë e vërtetë, adresa është falja e pesë namazeve të detyrueshme ditore, sepse namazi është sinonim i kënaqësisë dhe ekstaזës shpirtërore.

³⁵ Muslimi 15.

³⁶ Esrarus-salah, f. 115.

MËSOJE FAMILJEN TËNDE QË TË FALIN NAMAZIN

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأْمُرْ أَهْلَكَ بِالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ عَلَيْهَا لَا نَسْأَلُكَ رِزْقًا نَحْنُ نَرْزُقُكَ وَالْعَاقِبَةُ
لِلتَّقَوَى﴾⁽³⁷⁾

"Urdhëroje familjen tënde që të falin namazin dhe bëhu i qëndrueshëm në këtë! Ne nuk po të kërkojmë ndonjë ushqim, përkundrazi, jemi Ne që të ushqejmë.³⁷ E fundi i mirë u takon të devotshmëve." (Kurani, 20:132)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namazin kur t'i mbushin shtatë vjet..."³⁸

³⁷ "Domethënë: Ne nuk kërkojmë nga ti që ta furnizosh as veten, as familjen tënde, e ta lësh namazin për shkak të kërimit të ushqimit, ngaqë Ne (Allahu) e kemi marrë përsipër furnizimin tënd dhe të atyre." [Tefsir el-Kurtubi (11/263)]

³⁸ Ebu Davudi 495.

URTËSI

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: "Ai që fal namaz, troket në derën e Mbretit (Allahut) dhe, kujtdo që vazhdon së trokituri në atë derë, një ditë do t'i hapet."³⁹

MËDYSHJE

Më duhet ta mbaj familjen, ndaj s'mund të falem (!)

Allahu është Ai që të furnizon ty dhe familjen tënde. Madje, çdo dhunti që kemi, është nga Allahu, andaj duhet ta falënderojmë për këtë. Pos kësaj, namazi është një prej shkaqeve të shtimit të furnizimit, prandaj, si ka mundësi ta pakojë atë?!

KËSHILLË

Urdhëroje familjen tënde që të falen! Nëse të kundërshtojnë, kurrësi mos u dëshpëro e mos u spraps, por vazhdo t'i thërrasësh në namaz me urtësi dhe gjithnjë lute Allahun t'i udhëzojë ata.

³⁹ Musannef Ibn Ebi Shejbe (2/223).

ASNJËHERË MOS E HARRO QËLLIMIN E KRIJIMIT

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿فِي بُيُوتٍ أُذِنَ لِلَّهِ أَنْ تُرْفَعَ وَيُذْكَرَ فِيهَا اسْمُهُ يُسَبِّحُ لَهُ فِيهَا بِالْأُغْدُوِّ وَالْآصَالِ ۚ
رَجَالٌ لَا تُلْمِيهِمْ تِجَارَةٌ وَلَا بَيْعٌ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ ۚ﴾

"(Kjo dritë) është në shtëpitë (xhamitë) të cilat Allahu urdhëroi që të ngrihen dhe të përmendet në to emri i Tij. Atë e madhërojnë në to, mëngjes e mbrëmje, disa burra, të cilët shitblerja nuk i shpërqendron nga përmendja e Allahut, falja e namazit dhe dhënia e zekatit..."
(Kurani, 24:36-37)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Namazi që falet me xhemat është njëzet e pesë herë më i mirë sesa namazi që falet në shtëpi ose në vendin e punës. Kjo është kështu, ngase, kur njeriu e përkryen abdesin dhe niset për në xhami me qëllim që ta falë namazin, për çdo hap që bën, i ngrihet një shkallë dhe i fshihet një mëkat.

Teksa është në namaz, melekët pareshtur luten për të, duke thënë: “O Zot, mëshiroje atë!”, derisa nuk e prish abdesin. Madje, konsiderohet se është në namaz edhe gjatë pritjes së vetë namazit.”⁴⁰

URTËSI

Ibn Kajimi ka thënë: "Kush e ndien gëzimin më të madh të zemrës në namaz, nuk gjen asgjë më të dashur e më të ëmbël se ai, saqë do të dëshironte ta kalonte gjithë jetën duke u falur, pa u marrë me asgjë tjetër. Kur largohet nga namazi, vetëdija se së shpejti do t'i rikthehet i jep ngushëllim. Ai i rikthehet gjithmonë namazit dhe kurrë nuk ngopet me të." ⁴¹

MËDYSHJE

S'kam kohë të falem, duhet të punoj, se edhe puna është farz (!)

Nuk ka njeri në botë që punon 24 orë në ditë pandërprerë. Ai medoemos ndan një kohë për të ngrënë, për të fjetur, për të kryer nevojat fiziologjike etj. E, meqë është kështu, atëherë le t'i ndajë edhe nga pesë minuta për të kryer namazin.

⁴⁰ Buhariu 477, Muslimi 649.

⁴¹ Tarikul-hixhratejn ue babus-seadetejn (1/307).

KËSHILLË

Qëllimi i krijimit të njeriut është adhurimi i Allahut, kështu që asnjëherë mos e harro qëllimin e krijimit e të shkujdesesh ndaj namazit, sepse do të bëhesh pishman!

FALE NAMAZIN, QË ËSHTË NUR, E MOS RRI NË TERR

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿فَخَلَفَ مِنْ بَعْدِهِمْ خَلْفٌ أَضَاعُوا الصَّلَاةَ وَاتَّبَعُوا الشَّهَوَاتِ فَسُوفَ يَلْقَوْنَ
عَذَابًا ۝ إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ
شَيْئًا ۝﴾

"Pas tyre erdhën breza që lanë pas dore namazin dhe ndoqën epshtet e veta, kështu që ata do të gjejnë dënimin, përveç atyre që pendohen, besojnë dhe bëjnë vepra të mira, të atillët do të hyjnë në Xhenet dhe atyre nuk u bëhet asnjë padrejtësi." (Kurani, 19:59-60)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Për atë që e ruan (kujdeset për) namazin, ai do të jetë dritë, argument dhe shpëtim në Ditën e Gjykimit. Ndërkaq, për atë që nuk e ruan, nuk do të jetë as dritë, as argument, as shpëtim në Ditën e Gjykimit, ndaj do të

ringjallet me Faraonin, Karunin, Hamanin e Ubej ibn Halefin."⁴²

URTËSI

Ibn Kethiri ka thënë: "Ata që i humbin (braktisin) namazet, obligimet e tjera fetare i humbin edhe më lehtë, sepse namazi është shtylla e fesë dhe puna më e mirë që e bëjnë njerëzit."⁴³

MËDYSHJE

Nëse falem, thellobem në fe (!)

Nuk ka asgjë të keqe nëse njeriu thellohet në fe, sepse feja në të vërtetë është sistem jete. Islami nuk kërkon nga ne t'i përkushtohemi vetëm adhurimit e të shmangemi nga kënaqësitë e kësaj bote dhe t'i lëmë anash obligimet që kemi ndaj familjes, shoqërisë, e kështu me radhë. Madje, një gjë e tillë është e ndaluar dhe e përbuzur në Islam.

KËSHILLË

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë: "Namazi është dritë." Prandaj, o ti që nuk i kushton rëndësi namazit, fale namazin, e mos rri në terr!

⁴² Ahmedi 6576, Darimiu 2721, Ibn Hibbani 1467.

⁴³ Tefsir Ibn Kethir (5/243).

Mësimi i njëzetënjëtë

DY REKATE JANË MË TË VLEFSHME SE KJO BOTË DHE Ç'KA NË TË

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَمَا تُقَدِّمُوا لِأَنفُسِكُمْ مِنْ خَيْرٍ نَجِدُوهُ عِنْدَ
اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ﴾⁽¹⁾

"Faleni namazin dhe jepeni zekatin, sepse çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Pa dyshim, Allahu sheh mirë gjithçka që bëni." (Kurani, 2:110)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Dy rekatet e namazit të sabahut janë më të dobishme se kjo botë dhe ç'ka në të.”⁴⁴

⁴⁴ Muslimi 725.

URTËSI

Hasen el Basriu thoshte: "Namazi është puna më e mirë. Andaj, kush të dojë, le ta shtojë, e, kush të dojë, le ta pakësojë."⁴⁵

MËDYSHJE

Nuk mund ta lë gjumin për të falur namazin (!)

Kur është fjala për punë, njeriu e lë gjumin dhe fare nuk ankohet. Ndërkaq, për namaz ankohet, ndonëse namazi nuk merr shumë kohë. Andaj, le ta shkurtojë gjumin së paku ca minuta, që ta kryejë detyrën e vet ndaj Krijuesit, i Cili i ka dhuruar çdo mirësi.

KËSHILLË

Kur dy rekatet sunet të namazit të sababut vlejnë më shumë se kjo botë dhe ç'ka në të, atëherë paramendoje çfarë vlere të madhe ka namazi farz (i detyrueshëm)!

⁴⁵ Ez-Zuhd, Ahmed ibn Hanbel, f. 233.

EJA NË NAMAZ, EJA NË SHPËTIM!

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَاطِيعُوا الرُّسُلَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

"Faleni namazin, jepeni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, që të mëshiroheni!" (Kurani, 24:56)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë: “A doni t’ju tregoj për një gjë, me të cilën Allahu jua fshin mëkatet dhe jua ngre gradat (në Xhenet)?”

- Po si jo, o i Dërguari i Allahut! - thanë të pranishmit. Ai tha: “Përsosja e abdesit në raste vështirësie, hapat e shumtë deri në xhami dhe pritja e namazit pas namazit, kjo llogaritet përkushtim në adhurime.”⁴⁶

⁴⁶ Muslimi 251.

URTËSI

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: “Për birin e Ademit më mirë është t'i mbushen veshët me plumb të shkrirë sesa të dëgjojë thirrjen e ezanit e të mos i përgjigjet.”⁴⁷

MËDYSHJE

Si të falem, kur falen edhe shumë njerëz të këqij (!)

Gjithsecili do të japë llogari për vetveten, andaj mos lejo që ndokush, kushdo qoftë ai, të bëhet shkak që ti të mos i zbatosh detyrat e tua ndaj Krijuesit. Fundja, njerëz të këtillë ka kudo, por askush nuk e lë punën e vet nëse në vendin ku punon ka njerëz të këqij.

KËSHILLË

Kur të dëgjosh myezinin duke thënë: "hajje ale's-salah, hajje ale'l-felah - eja në namaz, eja në shpëtim", dije se ai po të thërret ty, kështu që përgjigju thirrjes e mos ia kthe shpinën, nëse dëshiron të jesh prej të shpëtuarve.

⁴⁷ Musannef Ibn Ebi Shejbe (1/303).

FAL NAMAZ NATE DHE SILLU MIRË ME NJERËZ

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَالَّذِينَ صَبَرُوا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِمْ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً وَيَدْرَءُونَ بِالْحَسَنَةِ السَّيِّئَةَ أُولَٰئِكَ لَهُمْ عُقْبَى الدَّارِ ﴿٢٢﴾﴾

"si dhe ata që bëjnë durim, duke kërkuar kënaqësinë e Zotit të tyre, e falin namazin, japin fshehurazi e haptazi nga ajo që u kemi dhënë dhe të keqen e kthejnë me të mirë. Këtyre u takon fundi i mirë." (Kurani, 13:22)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi صلی اللہ علیہ وسلم, ka thënë:

“O njerëz! Jepni për të ngrënë, përhapeni selamin, ruani lidhjet farefisnore, faluni natën, kur njerëzit flenë, se do të hyni në Xhenet paqësisht.”⁴⁸

⁴⁸ Sahih Ibn Hibbani (2/242).

URTËSI

Ibn Mesudi thotë: "Vlera e namazit të natës, krahasuar me atë të ditës, është si vlera e lëmoshës së fshehtë në raport me atë që jepet haptazi."⁴⁹

MËDYSHJE

Do të falem sapo t'i rregulloj disa probleme (!)

Ai që mendon të falet vetëm pasi t'i mbarojë problemet, nuk do të falet kurrë, sepse problemet nuk përfundojnë asnjëherë. Posa të mbarojë një problem, shfaqet ndonjë tjetër. Prandaj, falu e mos të të mashtrojë shejtani! Falu, sepse namazi është çelësi i rregullimit të të gjitha problemeve!

KËSHILLË

Fal namaḡ nate dhe sillu mirë me njerëz, që të arrish grada të larta në Xhenet!

⁴⁹ Shuabul-Iman, El-Bejheki (3098).

LUTE ALLAHUN QË TË TË BËJË TY DHE FAMILJEN TËNDE NAMAZLINJ

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي رَبَّنَا وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ﴾

"O Zoti im! Më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që e falin namazin. Zoti ynë! Ma prano lutjen!" (Kurani, 14:40)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Kur njeriu ngrihet dhe zgjon familjen e tij dhe falin dy rekate, ata shënohen në listën e atyre që e kujtojnë Allahun vazhdimisht."⁵⁰

⁵⁰ Ibn Hibbani 2568.

URTËSI

Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) falej gjatë natës aq sa dëshironte Allahu, ndërsa kur afrohej pjesa e fundit e natës, e zgjonte familjen e vet për të falur namaz duke u thënë: "Namazin, namazin" dhe ua lexonte këtë ajet: **"Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin..."** (Kurani, 20:132)⁵¹

MËDYSHJE

S'kam nevojë të falem, se më mjafton që gjysbin e kam pasur baxhi (!)

Në Ditën e Gjykimit gjithsecili do të dalë para Allahut i vetëm për të dhënë llogari. Atij nuk do të mund t'i ndihmojë askush po qe se i ka shpërfillur urdhrat e Zotit. Profeti Muhamed ﷺ i thoshte bijës së vet, Fatimes: *"Oj Fatime, shpëtoje veten nga Zjarri sepse unë nuk mund të të ndihmoj asgjë."* Atëherë, si është puna me të tjerët?!

KËSHILLË

Lute Allahun që t'ju bëjë namazlinj, ty dhe familjen tënde!

⁵¹ Ed-Durr el-menthur, Es-Sujuti (5/614).

MOS LEJO QË IMANI YT TË VIHET NË PIKËPYETJE

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿كُلُّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ رَهِيْنَةٌ ۖ إِلَّا أَصْحَابَ الْيَمِيْنِ ۖ فِي جَنّٰتٍ
يَتَسَاءَلُوْنَ ۚ عَنِ الْمُجْرِمِيْنَ ۖ مَا سَلَكَكُمْ فِي سَقَرٍ ۚ قَالُوا لَمْ نَكُ مِنَ
الْمُصَلِّيْنَ﴾⁵²

Çdo njeri është peng i veprave të veta, përveç të djathtëve, të cilët, në kopshtet e Xhenetit, do të pyesin njëri-tjetrin për keqbërësit: "Çfarë ju solli në Sekar (vend në Xhehenem)?" Ata do të përgjigjen: "Nuk ishim prej atyre që falnin namazin." (Kurani, 74:38-43)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

"Ajo që na dallon ne nga ata (jobesimtarët) është namazi. Andaj, ai që e lë namazin, ka rënë në kufër (mosbesim)."⁵²

⁵² Tirmidhiu 2621, Nesaiu 463, Ibn Maxhe 1079, Ahmedi 22987.

URTËSI

Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte:
"Nuk ka hise në Islam ai që nuk e fal namazin."⁵³

MËDYSHJE

S'kam nevojë të falem, ngase më mjafton besimi në Allahun (!)

Ai që e beson Allahun me të vërtetë, u përgjigjet urdhrave të Tij. E si mund të jetë besimtar i vërtetë ai që nuk e zbaton as shtyllën kryesore të Islamit pas shehadetit (dëshmisë islame)?!

KËSHILLË

Dijetarët muslimanë kanë mospajtime përkitazi me atë se a mund të qubet musliman personi që nuk e fal namazin. Andaj, falu dhe mos lejo që imani yt të vibet në pikëpyetje!

⁵³ El-Ikna'u, Ibn Mundhir (2/290).

PENDOHU PARA SE TË TË VIJË VDEKJA

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تِجَارَةً لَّن تَبُورَ﴾⁵⁴

"Vërtet, ata që lexojnë Librin e Allahut, e falin namazin dhe japin fshehurazi e haptazi nga ajo që u kemi dhënë, shpresojnë në një fitim që nuk do të humbë." (Kurani, 35:29)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "T'i shtojë në mesin e veprave dy rekate të lehta vullnetare që ju i nënvlerësoni, është më e dashur për këtë person - bëri me shenjë drejt një varri - sesa dunjaja juaj."⁵⁴

⁵⁴ Ibn Mubareku 31, Ibn Ebi Shejbe 7715, Taberiu 920.

URTËSI

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thoshte: "Ai që dëshiron ta takojë Allahun nesër (në Ditën e Gjykimit) si musliman, le të kujdeset për këto namaze, sa herë që thirret ezani për to."⁵⁵

MËDYSHJE

Unë e fal gjithmonë xhumanë, kjo mjafton (!)

Allahu na ka urdhëruar që t'i falim pesë namazet ditore e jo vetëm një namaz në javë. Së këndejmi, t'i përgjigjemi urdhrit të Zotit, sepse, fundja, Allahu nuk ka nevojë për namazin tonë, por ne kemi nevojë për të.

KËSHILLË

Çdo njeri, kur të vdesë do të shpresojë sikur t'i shtonte në peshoren e veprave të veta qoftë edhe dy rekate të lehta, edhe nëse është prej vepërmirëve. E si është puna atëherë me atë që ia kthen shpinën namazit dhe fare nuk interesohet për të, derisa t'i vijë vdekja! Pra, o ti që je ende gjallë, nxito në pendim dhe ktheju Krijuesit tënd që të të mos zërrë vdekja duke qenë i shkujdesur ndaj namazit!

⁵⁵ Muslimi 654.

FALE NAMAZIN NË KOHË TË CAKTUAR

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا﴾

"Me të vërtetë namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar." (Kurani, 4:103)

THËNIE PROFETIKE

Abdullah ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "E kam pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ se cila është vepra më e dashur tek Allahu i Lartësuar? Ai më është përgjigjur: *"Namazi në kohën e vet."*⁵⁶

URTËSI

Veki ibnul Xherrahu thoshte: "Ai që nuk kujdeset për namazin para se t'i hyjë koha, nuk i ka kushtuar rëndësi atij."⁵⁷

⁵⁶ Buhariu 2782, Muslimi 85.

⁵⁷ Hiljetul-eulija ue tabekatul-esfija, El-Isbahani (8/369).

MËDYSHJE

Është e pamundur të kujdesem për të gjitha namazet (!)

Allahu nuk ka bërë që koha e namazit të jetë shumë e ngushtë, aq sa do t'ia vështirësonte njerëzve kryerjen e tij në kohën e caktuar, por ka lënë kohë të mjaftueshme për çdo namaz. Pos kësaj, ka bërë edhe lehtësime të tjera, bie fjala, personi që është në udhëtim ose i sëmurë mund ta bashkojë namazin e drekës me atë të ikindisë dhe namazin e akshamit me atë të jacisë. Ndërkaq, kur ndokujt i ikën namazi për shkak të gjumit a të harresës, e fal atë sapo t'i kujtohet, gjë e cila nuk i shkruhet mëkat.

KËSHILLË

Fale namazin në kohën e tij të caktuar dhe në xhami, nëse ke ndonjë xhami afër!

MERR ABDES MIRË DHE FALË NAMAZIN NË XHAMI

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللَّهِ مَنِ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَحْشَ إِلَّا لِلَّهِ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَن يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ﴾⁽¹⁸⁾

"Mirëmbajtja e xhamive të Allahut u takon vetëm atyre që besojnë Allahun e Ditën e Fundit, që e falin namazin, e japin zekatin dhe nuk i frikësohen askujt përveç Allahut. Vërtet, këta janë të udhëzuar në rrugë të drejtë." (Kurani, 9:18)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Kush pastrohet në shtëpinë e vet, e pastaj shkon në një prej shtëpive të Allahut (xhami), për ta kryer njërin prej farzeve të Allahut, për çdo hap që bën, i shlyhet një mëkat, ndërsa hapi pasues ia lartëson gradën.”⁵⁸

⁵⁸ Muslimi 666.

URTËSI

Muhamed ibn Vasiu thoshte: "Nuk ka mbetur në këtë botë asgjë më e mirë sesa namazi me xhemat dhe takimi me vëllezër."⁵⁹

MËDYSHJE

Nuk mund të falem, se jam në shkollë, në punë a gjetkë (!)

Nëse dëshiron të falesh, Allahu do të ta lehtësojë të gjesh kohën dhe mundësinë për ta kryer namazin, sidomos kur dihet se nga njëri namaz në tjetrin ka kohë të mjaftueshme për kryerjen e tij.

KËSHILLË

Merr abdes mirë dhe fale namazin në xhami, në mënyrë që Allahu të t'i ngritë gradat në Xhenet!

⁵⁹ Hiljetul-eulija ue tabekatul-esfija, El-Isbahani (6/291).

Mësimi i njëzetënëntë

FALE NAMAZIN GJITHMONË ME PËRULJE

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١﴾ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٢﴾﴾

"Me të vërtetë, të shpëtuar janë besimtarët, ata që janë të përlurur në namazin e tyre." (Kurani, 23:1-2)

THËNIE PROFETIKE

Amaneti i fundit i të Dërguarit të Allahut ﷺ në prag të vdekjes ishte: "*Namazin, namazin dhe ata që i keni në sundim!*"⁶⁰

URTËSI

Abdurrahman es Sadi ka thënë: "Përlësia në namaz është shpirti i namazit... Për namazin që nuk ka përlësi e as prani të zemrës, ndonëse është i vlefshëm dhe ka

⁶⁰ Nesaiu 7095, Ibn Maxhe 2697, Ahmedi 12169.

shpërblim edhe për të, shpërblimi jepet për aq sa është e përqendruar zemra në namaz."⁶¹

MËDYSHJE

Nëse falem do të më bëjë problem familja, shefi... (!)

Fale namazin dhe bëhu i patundur në këtë, pa marrë parasysh pengesat që mund të të dalin në fillim të kësaj rruge, sepse namazi, pa dyshim, është çelësi i suksesit, lumturisë dhe lehtësimit në çdo çështje. Dije, gjithashtu, se shumë nga pengesat që mund të të sillen në kokë në fakt janë vetëm imagjinare. Zbatoje detyrën tënde ndaj Mbretit të mbretërve, Krijuesit dhe Sunduesit të çdo gjëje, të Gjithëfuqishmit dhe lute Atë të t'i lehtësojë të gjitha çështjet, sepse Ai ka premtuar në Kuran se do të gjejë rrugëdalje për atë që i frikësohet Atij.

KËSHILLË

Fale namazin gjithmonë dhe duke qenë i përvuilur gjatë kryerjes së tij, sepse kjo është rruga e suksesit, shpëtimit, lumturisë dhe shpërblimit madhbështor!

⁶¹ Tejsir el-Kerim er-Rrahman, f. 547.

Mësimi i tridhjetë

ADHUROJE ZOTIN TËND DERISA TË TË VIJË VDEKJA

AJET KURANOR

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَكُنْ مِنَ السَّاجِدِينَ﴾⁶² وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّى يَأْتِيَكَ
الْيَقِينُ ﴿٩٩﴾

"Lartësoje Zotin tënd me lavdërim e ji prej atyre që bëjnë
sexhde dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!"
(Kurani, 15:98-99)

THËNIE PROFETIKE

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ, ka thënë:

“Robi është më së afërmi Zotit të vet atëherë kur është në
sexhde.”⁶²

⁶² Muslimi 482.

URTËSI

Ebul-Hasen en-Nedeviu ka thënë: "Namazi është streha dhe mburoja e muslimanit, është lidhja më e fortë dhe litari i zgjatur mes tij dhe Zotit të vet, në të cilin mbahet, është ushqimi i shpirtit, melhemi i plagëve, ilaçi i zemrës, mbështetja e të pambrojturit, siguria e të frikësuarit, forca e të dobëtis dhe arma e të paarmatosurit."⁶³

MËDYSHJE

Bën edhe pa namaz, nuk është e domosdoshme që të falem (!)

Allahu nuk ka nevojë për namazin tënd, madje as besimtarët. Ai që ka nevojë për të je pikërisht ti. Në qoftë se e dëshiron lumturinë e kësaj bote dhe atë të botës së amshuar, atëherë duhet të falesh patjetër. Zgjedhja është në dorën tënde, pra, vendos vetë!

KËSHILLË

Lumturia e vërtetë qëndron në namaz dhe në adhurimin ndaj Krijuesit. Po e kërkoje gjetiu, të jesh i bindur se nuk do ta gjesësh kurrë.

⁶³ El-Erkan el-erbeah, f. 30.

Mëso faljen e namazit

Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.

(Kuran 4:103)

1 SABAHU

Sabahu (fexhër) falet në agim, nga koha kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit dhe vazhdon deri para lindjes së diellit.

2 DREKA

Dreka (dhuhër) falet pasi të lëvizë dielli prej zenitit deri në pozitën kur hija e një objekti arrin gjatësinë e atij objekti.

3 IKINDIA

Ikindia (asër) falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri para perëndimit të diellit.

4 AKSHAMI

Akshami (magrib) fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit.

5 JACIA

Jacia (isha) falet pasi të errësohet plotësisht horizonti dhe zgjat deri para agimit.

VITRI

Namazi i vitrit falet pas namazit të jaciës. Nuk është mirë të lihet pa falur, edhe pse nuk është farz. Muhamedi (ﷺ) gjithmonë e ka falur namazin e vitrit.



Forma e faljes së namazit - VIDEO

Përshkrim i detajuar nga abdesi deri te selami

Tabela e rekateve

Namazi përbëhet nga pjesët e quajtura rekate

Namazi	Sunet (para)	Farz	Sunet (pas)
Sabahu	2	2	
Dreka	4	4	2
Ikindia	4	4	
Akshami		3	2
Jacia		4	2

Vitri 3

Sqarim: Namazet farz janë namazet e detyrueshme.

Abdesi

Para se të fillojmë faljen e namazit, duhet të marrim abdes.

1



Thuaj Bismilah dhe
laj duart deri në kyçe

2



Shpëlaj gojën
3 herë

3



Shpëlaj hundën
3 herë

4



Laj fytyrën 3 herë

5



Laj dorën e djathtë
deri mbi bërryl,
pastaj edhe të majtën,
nga 3 herë

6



Me duar të lagura
fërko kokën

7



Me duar të lagura
fërko veshët

8



Laj këmbën e djathtë
pastaj të majtën deri
mbi kyçe nga 3 herë

i

**Abdesi është kusht
për faljen e
namazit!**

Falja e Sabahut

2 rekate

1 FILLIMI I NAMAZIT

Qëndro në këmbë, drejtohu nga kibra, ngriji duart dhe thuaj:

Allahu Ekber



2 REKATI I PARË

Vendos dorën e djathtë mbi të majtën dhe thuaj:

Subhanek'Allahumme, ve bihamdike,
ve tebareke'smuke, ve teala xhedduke,
ve la ilahe gajruke.

Eudhu bil-lahi mineshe-shejtanirr-rraxhim




FATIHA

Bismilahirr-Rahmanirr-Rrahim
Elhamdu lil-lahi Rabil-alemin
Err-Rahmanirr-Rrahim, Maliki jevmid-din
ijjake na'budu ve ijjake neste'in
ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine
en'amte 'alejhim gajril-magdubi 'alejhim
ve led-daalin. AMIN

KEV'THER

Bismilahirr-Rahmanirr-Rrahim
Inna e'atajnakel-kev'ther.
Fesal-li, li rabbike venhar.
inne shanieke huvel-ebter.



Allahu Ekber

Subhane Rabijel-'Adhim

3 herë



Semi'Allahu limen hamideh
Rabbena ve lekel-hamd



Allahu Ekber

Subhane Rabi'el a'la

3 herë



Allahu Ekber

Rabbi'gfir li, Rabbi'gfir li



Allahu Ekber

Subhane Rabi'el a'la

3 herë

4 REKATI I DYTË

Ngrihu në këmbë duke thënë:

Allahu Ekber



FATIHA

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim
Elhamdu lil-lahi Rabil-alemin
Err-Rrahmanirr-Rrahim, Maliki jevmid-din
ijjake na'budu ve ijjake neste'in
ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine
en'amte 'alejhim gajril-magdubi 'alejhim
ve led-daalin. AMIN

IHLAS

Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim
Kul huvAllahu Ehad. Allahus-Samed.
Lem jelid, ve lem juuled.
ve lem jekun lehu kufuven ehad.

5 RUKU DHE SEXHDE



veproni si në figurat nr.

3



Allahu Ekber

qëndro ulur

Et-Tehijatu lil-lahi, ves-salavatu, vet-tajjibatu.
Es-selamu 'alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi
ve berekatuhu. Es-selamu 'alejna
ve 'ala 'ibadil-lahis-salihin.

Eshhedu en la ilahe il-lallah ve eshedu
enne Muhammeden 'abduhu ve resuluhu.

SALAVATET

Allahumme sal-li 'ala Muhammedin
ve 'ala ali Muhammed, kema sal-lejte 'ala Ibrahim, e,
ve 'ala ali Ibrahim, inneke Hamidun Mexhid.

Allahumme barik 'ala Muhammedin
ve 'ala ali Muhammed, kema barekte 'ala Ibrahim, e,
ve 'ala ali Ibrahim, inneke Hamidun Mexhid.


DUAJA

Rabbena atina fid-dunja haseneten,
ve fil-ahireti haseneten ve kina 'adhaben-nar.

Rabbena'gfir li ve li validejje ve lil-mu'minine
jevme jekumul-hisab.

Es-selamu 'alejkum
ve rahmetullah

ktheje kokën
në anën e djathtë



Es-selamu 'alejkum
ve rahmetullah

pastaj ktheje kokën
në anën e majtë

Falja e drekës, ikindisë dhe jacosë

4 rekate

Këto namaze kanë nga 4 rekate (farz - të detyrueshme).

Së pari i fal dy rekatet e para njësoj si në namazin e sabahut deri në veprimin **6**, pastaj duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e tretë.

Rekati i tretë

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fatiha** (si në veprimin **2**). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin **3**), mandej duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e katërt.

Rekati i katërt

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fatiha** (si në veprimin **4**). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin **5**), mandej qëndron në uljen e **teshehudit** deri në përfundim të namazit (si në veprimet **6** dhe **7**).

Falja e akshamit

3 rekate

Namazi i Akshamit ka 3 rekate (farz - të detyrueshme).

Së pari i fal dy rekatet e para njësoj si në namazin e sabahut deri në veprimin **6**, pastaj duke thënë **Allahu Ekber** ngrihesh në këmbë për rekatën e tretë.

Rekati i tretë

I lidh duart dhe e thua vetëm suren **Fatiha** (si në veprimin **4**). Pastaj e kryen **rukunë dhe sexhden** (si në veprimin **5**), mandej qëndron në uljen e **teshehudit** deri në **përfundim të namazit** (si në veprimet **6** dhe **7**).

Namazi dhe Kurani janë të pandashëm!

Mëso leximin e Kuranit shpejt dhe lehtë!

*Skano QR-kodin dhe ndiq
videot tona mësimore në
YouTube!*



📌 Këto mësimë bazohen në librin „Abetarja kuranore“, të cilin mund ta gjeni në kanalin tonë në Telegram: „<https://t.me/institutigerma>“

📖 Për të shkarkuar librin, skeno kodin e mëposhtëm:



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

28-238

Kastrati, Jusuf

Për ty që s'falesh / Jusuf Kastrati - Prishtinë: Instituti
Germa, 2024. - 80 f.; 18 cm.

Feja islame -- Doktrinat fetare

ISBN 978-9951-9125-8-7

Aleph [000108934]